



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
АГЕНЦИЈА ЗА АУДИО И АУДИОВИЗУЕЛНИ МЕДИУМСКИ УСЛУГИ

Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, në bazë të nenit 18 paragrafi 1 alineja 12, nenit 20 paragrafi 1 alineat 4 dhe 10, ndërsa në lidhje me nenin 8 paragrafi 4 alineja 3 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), nenit 15 paragrafi 1 alineja 12 dhe nenit 41 paragrafi 1 alineat 4 dhe 8 të Rregullores për punën e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale nr. 01-3632/1 të datës 22.08.2025, në lidhje me rezultatet nga revizioni i kryer nga Shoqëria për revizion dhe konsulencë biznesi A&BA GROUP DOOEL Shkup, dhe në përputhje me Përfundimin e Këshillit të Agjencisë nr. 02-1331/2 të datës 31.03.2026, në seancën e 12-të të mbajtur më 30.03.2026, përcaktoi këtë:

Qëndrimi

i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale në lidhje me rezultatit e revizionit të kryer nga revizori i pavarur për vitin 2025.

Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale pajtohet me mendimin e dhënë në Raportin e Revizionit për vitin 2025, i regjistruar në arkivin e Agjencisë me numër 02-1044/2 të datës 17.03.2026, se pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, gjendjen financiare të Agjencisë më datë 31.12.2025.

Sa i përket pjesës "Baza për mendim me rezervë", që i referohet vlerës së tokës nën ndërtesë, Agjencia nuk pajtohet, për arsye se e njëjta është përfshirë në bilancet sipas rekomandimit të Entit Shtetëror për Revizion.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele**

Kryetar i Këshillit,

Mr. Saho Stefanovski

**Agjencia për Shërbime
Mediatike Audio dhe
Audiovizuele
02-147/1
31.03.2026
Shkup**



**Agjencia për Shërbime
Mediatike Audio dhe
Audiovizuele**

**rr. Makedonija rr.38
1000 Shkup
Republika e Maqedonisë
së Veriut**

Tel. + 389 2 3103 400

**www.avmu.org.mk
www.avmu.mk
contact@avmu.mk**

